

VENDIM
Nr. 645, datë 3.8.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE
NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË
ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA “5 MAJI”, DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE 6,
ZONA “KOMBINAT”, BASHKIA TIRANË**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 1130, datë 24.12.2020; nr. 202, datë 25.3.2021; nr. 424, datë 8.7.2021;
nr. 773, datë 15.12.2021; nr. 787, datë 12.12.2022; nr. 673, datë 6.12.2023; nr.366, datë 5.6.2024)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit nga Bashkia Tiranë, në masën 14 385 346 958 (katërmëdhjetë miliardë e treqind e tetëdhjetë e pesë milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesat publike, në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë.

2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë në masën 1 136 002 934 (një miliard e njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2.1 Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 1 490 233 627 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH dhe i transferohet Bashkisë Tiranë për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2.2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 3 300 234 940 (tre miliardë e treqind milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat” në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2.3. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, në masën 3 430 228 255 (tre miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji” dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat” në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2.4 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 2 430 930 665 (dy miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për

financimin e rindërtimit të njërive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Fondet e mbetura të papërdorura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe